



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201401351/24

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda:** *Rekomandohet ushtrimi kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Pogradecë, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetasit F.C.*

**Drejtuar :** **Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Rregjistrimit  
Pasurive të Paluajtshme**  
Z.Ilirian Muho

**Për dijeni :** **Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së  
Drejtësisë,**  
zj.Llambriola Misto

**TIRANE**

**Z. F.C**  
Adresa :

**POGRADEC**

Z.Kryeregjistrues!

Në procesin e shqyrtimit të ankesës së shtetasit F.C., në të cilën është prezantuar shkelja e së drejtës të pronësisë, Institucioni i Avokatit të Popullit, konsideron, se, qëndrimi që është mbajtur dhe mbahet prej ZVRPP, Pogradec, është i parregullt, dhe në cënim të parimit të ligjshmërisë, mbrojtjes së interes publik dhe të drejtave të personave private, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjshmërisë, sikurse parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative dhe të detyrueshëm në kuptim dhe zbatim të këtij Kodi.

Çështja për të cilën ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, qëndron si më poshtë prezantuar.

Familja bujqësore e shtetasit F.C., mbi bazë të ligjit nr.7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", ka përfituar në pronësi sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 6381/R, datë 18.04.2005, të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Çërravë, 2315m2 tokë bujqësore në parcelën me numër 113/31, ZK 2420, e ndodhur në Fshatin Leshnicë, në vendin e quajtur "Kopaçe".

Për të mundësuar pajisjen me dokumente pronësie mbi pasurinë e lartpërmendur, ankuesi, rezulton të ketë kryer aplikim pranë ZVRPP, Pogradec me nr.13, datë 05.01.2015. Në përgjigje të aplikimit, ZVRPP, Pogradec, në shkresën nr.3222/1 prot, datë 30.10.2015, drejtuar Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë, shprehet se, për këtë çështje, përcaktimet e kryera në Udhëzimin nr. 2, datë 13.06.2013, *“Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)”*, të Këshillit të Ministrave, pika 4, nuk lejojnë regjistrimin e titullit të pronësisë, Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 6381/R, datë 18.04.2005, të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Çërravë, pa u plotësuar më parë kushtet e përcaktuara në këtë pikë.

Në kushtet kur Udhëzimin nr. 2, datë 13.06.2013, është shfuqizuar sipas VKM nr. 994, datë 09.12.2015, pika 7, *“Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”*, Institucioni i Avokatit të Popullit, me shkresën nr. K3/F21-15 Prot, datë 18.04.2016, ka rekomanduar ZVRPP, Pogradec;

*“Marrjen e masave të menjëhershme për trajtimin e çështjes së regjistrimit të titullit të pronësisë, Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 6381/R, datë 18.04.2005, të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Çërravë, që i përketë familjes bujqësore të ankuesit F.C. sipas përcaktimeve të kryera në VKM nr. 994, datë 09.12.2015, “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”.*

Për çështjen e prezantuar, Regjistruesi i ZVRPP, Pogradec, me shkresën nr. 2207/1 Prot, datë 03.06.2016, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, shprehet se;

*“... në bazë të VKM Nr.994, datë datë 09.12.2015, “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”*, Manualit udhëzues nr.2803, datë 30.03.2016 të ZQRPP, dhe rekomandimit të Avokatit të Popullit, ZVRPP, Pogradec, i është drejtuar Bashkisë, Pogradec, me shkresën nr.1740, datë 22.04.2016, për konfirmimin e AMTP-së nr. 6381/R, datë 18.04.2005, dhe planit të rilevimit për të përcaktuar sipërfaqen e parcelës që i konrespondon pasuria në AMTP sepse AMTP-ja nr. 6381/R, datë 18.04.2005, disponohet nga vetë qytetari dhe nuk është e depozituar në arshivën e ZVRPP, Pogradec. Në rregjistrat e ZVRPP, Pogradec, pasuria nr.113/31, vol 7, faqe 40, ZK 2420, “arë”, ka sipërfaqen S=2416m<sup>2</sup> “Shtet”, kurse në AMTP-në nr. 6381/R, datë 18.04.2005, sipërfaqja është S=2315m<sup>2</sup>, pra sipërfaqja në AMTP është më e vogël se sipërfaqja në kartelën e pasurisë.

Në përgjigje të Shkresës nr.1740 Prot, datë 25.04.2016, Bashkia, Pogradec, me Shkresën “Kthim përgjigje”, nr.1133 Prot, datë 18.05.2016, bën me dije se disponon “Vërtetimin Civil” të Gjykatës, i cili vërteton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Pogradec, është regjistruar çështja civile me nr.00108-240 regjistrimi themeltar, datë 01.02.2016, që i përket;

Paditës: FC.

Të paditur: R.Sh, LSh

Objekti: Lirim e dorëzim trualli. Shpërblim dëmi.

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë në nenin 36 paragrafi i tretë, shprehet se;

*“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u shqyrtuar nga Gjykata. Pës sa sipër Bashkia, Pogradec, nuk mund të shprehet për kërkesën tuaj...”*

Referimet dhe deklaratimet e Regjistruerit të ZVRPP, Pogradec, si më sipër cituar, në gjykimin e Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të justifikojmë mosdhënien e shërbimit të kërkuar, ankuesit F.C., pra pajisjes së tij me dokumentacion pronëse për pasurinë e fituar në pronësi sipas AMTP-në Nr. 6381/R, datë 18.04.2005.

Regjistruerit i ZVRPP, Pogradec, nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë pengesë, që në referim të parashikimeve të ligjit Nr.33/2012, *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, të ndryshuar, si dhe VKM Nr. 994, datë 09.12.2015, *“Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”*, të mundësoj lëshimin e dokumenteve të kërkuara prej z.Cane.

Në kushtet kur ankuesi ka dorëzuar në rrugë postare qysh në Vitin 2012, kopje të njehsuar me origjinalin nga noteri, të AMTP-në Nr. 6381/R, datë 18.04.2005, si dhe kopjen origjinale të plan rievimit të pasurisë prej 2315m<sup>2</sup> të fituar në pronësi sipas AMTP-së së lartpërmendur, e vlerësojmë të pambështetur në ligj kërkesën e ZVRPP, Pogradec, drejtuar Bashkisë, Pogradec, për konfirmimin e AMTP-në Nr. 6381/R, datë 18.04.2005.

Tjetër pyetje që lind referuar deklaratimit të Regjistruerit të ZVRPP, Pogradec, se: *“... Në rregjistrat e ZVRPP, Pogradec, pasuria Nr.113/31, vol 7, faqe 40, ZK 2420, “arë”, ka sipërfaqen S=2416m<sup>2</sup> “Shtet”, kurse në AMTP-në Nr. 6381/R, datë 18.04.2005, sipërfaqja është S=2315m<sup>2</sup>, pra sipërfaqja në AMTP është më e vogël se sipërfaqja në kartelën e pasurisë...”, është; Mbi bazë të cilit titulli pronësie është pasqyruar në hartën kadastrale të ZVRPP, Pogradec, pasuria S=2416m<sup>2</sup>, “Shtet” dhe cili subjekt e ka kryer atë?*

Besojmë se, organi që ka nxjerr aktin, AMTP Nr. 6381/R, datë 18.04.2005, në referim të parashikimit të kryer në nenin 196 të Kodit Civil, se;

*“Gjykatat, noterët, përmbaruesit gjyqësorë dhe organet e tjera shtetërore detyrohen t'i dërgojnë për regjistrim zyrës që administron regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, kopje të vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, ose që deklarohen të pavlefshme veprime juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë”*,

ka mundësuar dërgimin pranë ZVRPP, Pogradec, të AMTP-së në fjalë, dhe se mbi bazë të saj është mundësuar pasqyrimi në hartën kadastrale të ZVRPP, Pogradec, të pasurisë S=2416m<sup>2</sup>.

Sa për ndryshimin, diferencën në sipërfaqe prej 101m<sup>2</sup>, midis sipërfaqes së pasurisë të përfituar në pronësi prej Familjes Cane, sipas AMTP Nr. 6381/R, datë 18.04.2005, dhe regjistrimit të saj në ZVRPP, Pogradec, konstatojmë se, Regjistruerit i ZVRPP, Pogradec, nuk ka parasysh përcaktimin e kryer në pikën d, paragrafi 4, të VKM Nr.994, datë 09.12.2015, *“Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”*, në të cilën thuhet se:

*“Në rast se sipërfaqja e të gjitha pasurive, të dhëna me AMTP, del më e vogël se sipërfaqja e regjistrimit fillestar të tyre, e pasqyruar në kartelat respektive, zyrtare vendore e regjistrimit vijon me realizimin e shërbimit të aplikuar, por sipërfaqja e*

*tepërt i zbritet vetëm njerës prej pasurive, sipas deklaratës së përfituesit të AMTP-së”.*

Konfirmimi i faktit prej Bashkisë, Pogradec, në Shkresën Nr. 1133 Prot, datë 18.05.2016, drejtuar ZVRPP, Pogradec, se disponon “Vërtetim civil” të Gjykatës, i cili vërteton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Pogradec, është regjistruar çështja civile me Nr.00108-240 regjistrimi themeltar, datë 01.02.2016, që i përket;

Paditës: F.C.

Të paditur: R.Sh., L.Shk.

Objekti: Lirim e dorëzim trualli. Shpërblim dëmi, kurrësesi nuk mund të shërbej si shkak për Regjistruesin e ZVRRP, Pogradec, për mosdhënien e shërbimit të kërkuar prej ankuesit F.C.

Bashkia, Pogradec, në qëndrimin e shprehur në Shkresën Nr. 1133 Prot, datë 18.05.2016, drejtuar ZVRPP, Pogradec, gabon lidhur me interpretimin e dispozitës, nenit 36 të K.Pr.C., përsa i përket konfirmimit të AMTP Nr. 6381/R, datë 18.04.2005, sikurse kërkuar prej ZVRPP, Pogradec.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit të punës, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresur se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës së ankuesit në fjalë.

Për arsyet e bërë me dije në këtë shkresë, Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

## **REKOMANDOJMË**

*Ushtrimi kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Pogradec, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetasit F.C.*

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Bashkëlidhur ju dërgojmë:*

*Kopje të shkresës nr.2207/1 prot, datë 03.06.2016, të ZVRPP, Pogradec, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.*

*Kopje të shkresës nr.1970/1 prot, datë 10.05.2016, të ZVRPP, Pogradec, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.*

*Kopje të shkresës nr.1740 prot, datë 25.04.2016, të ZVRPP, Pogradec, drejtuar Avokatit të Popullit.*

*Kopje të shkresës nr.1740 prot, datë 22.04.2016, të ZVRPP, Pogradec, drejtuar Bashkisë, Pogradec.*

*Kopje të shkresës nr.1133, datë 18.05.2016, të Bashkisë, Pogradec, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Vërtetim nr.00108-240, datë 25.04.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Pogradec.*

*Vendim nr.03, datë 20.04.2005, i Komunës Çërravë, për trajtimin me tokë bujqësore të Familjes së F.C me 2315m2 tokë bujqësore.*

*Relacion padatë I specialistit të Komunës Çërravë, Mitat Bardhi.*

*Proces verbal datë 18.04.2005, i Komisionit të Tokës, Fshati Çërravë.*

*Hartë treguese e Regjistrimit për pasurinë nr.113/31, ZK 2420, Fshati Leshicë, Pogradec.*

*Shkresë nr.2604/1 prot, datë 15.06.2006, i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.*

*AMTP nr. 6381/R, datë 18.04.2005, të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Çërravë.*

*Vërtetim datë 18.04.20?, i Kryeplakut të Fshatit Leshnicë.*

*AMTP nr. 6381, datë 22.04.1992, të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Çërravë.*

*Kartelë e pasurisë së palaujtshme e lëshuar nga ZVRPP, Pogradec, për pasurinë nr.113/31, ZK 2420, Vol 7, faqe 40.*

*Kartelë e pasurisë së palaujtshme e lëshuar nga ZVRPP, Pogradec, për pasurinë nr.83/44, ZK 2420, vol 67, faqe 64.*

*Kartelë e pasurisë së palaujtshme e lëshuar nga ZVRPP, Pogradec, për pasurinë nr.150/19, ZK 2420, Vol 2, faqe 82.*

*Kartelë e pasurisë së palaujtshme e lëshuar nga ZVRPP, Pogradec, për pasurinë nr.11317/31, ZK 2420, Vol 6, faqe 63.*

*Kopje të shkresës nr.1740 prot, datë 22.04.2016, të ZVRPP, Pogradec, drejtuar Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekturës Korçë.*

*Kopje të shkresës nr.14/1 prot, datë 19.02.2015, e Komisionit të verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekturës Korçë, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Kopje të shkresës nr.4/1 prot, datë 21.01.2016, e Prefektit të Qarkut, Korçë, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Kopje të shkresës nr.F-33/6 prot, datë 21.09.2016, e Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Kopje të shkresës nr.682/1 prot, datë 09.04.2013, të ZVRPP, Pogradec, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.*

*Kopje të shkresës nr.598/1 prot, datë 28.03.2013, e Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Kopje të shkresës nr.984/1 prot, datë 07.11.2014, e Kryeregjistruesit të ZQRPP, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Kopje të shkresës nr.1700/3 prot, datë 27.03.2015, e Kryeregjistruesit të ZQRPP, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Kopje të shkresës nr.1700/6 prot, datë 21.10.2015, e Kryeregjistruesit të ZQRPP, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Kopje të shkresës Nr.57/1 prot, datë 29.01.2016, e Kryeregjistruesit të ZQRPP, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Kopje të shkresës nr.F-257/1 prot, datë 29.12.2015, e Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Kopje të shkresës nr.6215/3 prot, datë 03.12.2012, e Kryeregjistruesit të ZQRPP, drejtuar ZVRPP, Pogradec.*

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Konceptoi dhe Daktilografoi  
A.Gjoleka**

**Etilda GJONAJ(SALIU)**